Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

RREGULLAT E PROCEDURËS

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

1. Këshilli i Mediave të Shkruara shqyrton ankesat e pranuara për shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës dhe gjithashtu procedon rastet me iniciativë te vet. Ankesat mund të bëhen me shkrim, sipas procedurave të Sekretariatit. Ankesa parashtrohet, ose rasti për një ankesë hapet brenda një muaji nga data e publikimit të përmbajtjes kontestuese.
2. Ankesat mund të bëhen nga kushdo. Ankesat anonime nuk shqyrtohen. Ankesat kundër gazetarëve individualë nuk pranohen. Ankesat pranohen vetëm nëse ato ngriten kundër medias përkatëse të shkruar, portalit apo agjensisë së lajmeve.
3. Zyrtari i ankesave shqyrton të gjitha ankesat e pranuara dhe vendos nëse ankesa bie në kompetencat e Këshillit të Mediave të Shkruara.
4. Nëse ankesa është në mënyrë të qartë jashtë kompetencave të Këshillit të Mediave të Shkruara, zyrtari i ankesave, pas diskutimit me drejtorin, e kundërshton ankesën dhe ankuesi informohet për arsyet e kundërshtimit të ankesës. Drejtori e informon Bordin e KMShK-se për ankesat e refuzuara.
5. Çdo ankese që është në kompetencën e Këshillit të Mediave të Shkruara, i jepet një numër reference dhe për atë ankesë hapet një dosje. Edhe ankesave të bëra me iniciativën e vet Këshillit të Mediave të Shkruara u jepet një numër reference dhe hapet një dosje për to.
6. Media e shkruar, portali apo agjencia e lajmeve, kundër së cilës është paraqitur ankesë, ka mundësi që, brenda 15 ditëve, nga data e dorëzimit të ankesës në sekretarinë e Këshillit, të përgjigjet dhe komentojë çdo ankesë të bërë apo çdo rast të hapur në Këshillin e Mediave të Shkruara.
7. Drejtori, së bashku me kryetarin e Bordit, ndërmarrin hapat në mënyrë që të pajtojnë palët e përfshira, përfshirë këtu inkurajimin e medias së shkruar, portalit apo agjencisë së lajmeve kundër së cilës është ngritur ankesa, që të garantojë të drejtën e përgjigjes ndaj ankuesit, nëse një gjë e tillë është e aplikueshme.
8. Zyrtari i ankesave, kur e sheh të përshtatshme, së bashku me drejtorin, shqyrton të gjitha rastet, duke kërkuar ndonjë provë të nevojshme nga ankuesi dhe media e shkruar kundër së cilës është bërë ankesa, ose nga ndonjë burim tjetër.

Rezultatet e një shqyrtimi të tillë, së bashku me çdo material të pranuar apo të mbledhur, futen në dosjen e rastit.

9. Nëse çështja nuk zgjidhet brenda një muaji nga data e hapjes se rastit, kjo çështje i dorëzohet Bordit të Këshillit të Mediave të Shkruara. Për ankesën apo rastin e hapur merret një vendim përfundimtar brenda tre muajve, nga dita e hapjes së rastit, përveç nëse ka arsye të veçanta që të veprohet ndryshe.

10. Zyrtari i ankesave paraqet rastet në Bordin e Këshillit të Mediave të Shkruara, duke shpalosur të gjitha dëshmitë e mbledhura, hulumtimet e bëra si dhe ndonjë përpjekje të bërë drejt pajtimit dhe rezultatin e arritur nga përpjekja e tillë. Pas rekomandimit të drejtorit, ankuesi dhe përfaqësuesit e medias, kundër së cilës është bërë ankesa, mund të thirren për seancë dëgjimore, nëse kështu vendoset nga Bordi i Këshillit të Mediave të Shkruara.

11. Bordi i Këshillit të Mediave mund të refuzojë një ankesë. Nëse veprohet kështu ankuesi do të informohet për arsyet e refuzimit të ankesës.

12. Këshilli i Mediave të Shkruara mund të urdhërojë një anëtar të vetin që të publikojë vendimet në vendin e caktuar nga Këshilli i Mediave të Shkruara.

13. Bordi i Këshillit të Mediave të Shkruara mund të vendosë për ndërprerjen e anëtarësimit të secilit anëtar, ashtu siç është parashikuar me Statut.

14. Çdo vendim i marrë i dërgohet menjëherë medias në fjalë brenda tre ditëve të punës.

15. Vendimet bëhen publike dhe u dërgohen mediave të shkruara, portaleve apo agjnecive të lajmeve, anëtare të KMSHK për publikim jokomercial. Mediat e përfaqësuara në Këshillin e Mediave të Shkruara publikojnë vendimet e Këshillit të Medieve të Shkruara pa pagesë dhe në vendin e duhur.

16. Shënimet mbahen për të gjitha rastet dhe publiku ka qasje në to. Materialet e mbajtura nga Këshilli i Mediave të Shkruara duhet të jenë në dispozicion për publikun, përveç nëse Ligji mbi Qasjen në Informata parashikon ndryshe.

17. Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës merr në shqyrtim edhe ankesat kundër mediave të shkruara, portaleve apo agjencive të lajmeve – joanëtarë të KMShK-së, ashtu siç është parashikuar në Statut. Lidhur me këto ankesa, KMShK, zbaton procedurën si për anëtarët e vet. Nëse media – joanëtare, nuk dëshiron të bashkëpunojë me KMShK-së, sipas procedurës së rregullt, KMSHK nxjerr opinion për ankesën në bazë të vlerësimeve që ai i siguron nga burimet tjera.